



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 42/12

Prishtinë, më 06.11.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Latif Gashi, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Munguan: Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Behxhet Haliti Drejtor i ATK-së, Lulzim Rafuna Drejtor i Zyrës Ligjore në Doganat e Kosovës, Ferid Agani Ministër i Shëndetësisë, Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Albulena Gashi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit dt. 10.10.2012 dhe 22.10.2012;**
3. **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 06/94 të datës 10 tetor 2012, për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Projektligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
6. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, theksoi se në rendin e ditës së mbledhjes së sotme është vendosur gabimisht pika e pestë, e cila do të jetë objekt shqyrtimi në mbledhjen e radhës së komisionit. Për këtë lëshim teknik jeni njoftuar paraprakisht edhe nga stafi që mbështet punën e komisionit. Prandaj propozoi që rendi ditës të miratohet pa pikën 5.

Rendi i ditës u miratuar njëzëri pa pikën 5.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit dt. 10.10.2012 dhe 22.10.2012

Latif Gashi theksoi se në procesverbalin e dt. 10.10.2012 në pjesën hyrëse ku flitet për pjesëmarrësit e anëtarëve të komisionit në mbledhje, nuk është përfshirë emri i tij, edhe pse më tutje në tekst janë përfshirë diskutimet që ka patur për pikat e caktuara. Kërkoj që të bëhet ky përmirësim.

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e dt. 10.10.2012 dhe 22.10.2012 miratohen me vërejtjen e z. Gashi që duhet përmirësuar.

3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 06/94 të datës 10 tetor 2012, për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014

Behxhet Haliti sqaroi përmbajtjen e propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e periudhës kalimtare për lirimet nga TVSH-së për mallrat dhe furnizime në mallra që janë të përcaktuara në nenet përkatëse të ligjit për TVSH-në. Janë dhënë edhe arsyetimet për nevojën e vazhdimin të lirimeve deri në dhjetor 2014. Prandaj në pajtim me nenin 64.2 të Ligjit për TVSH-në është drejtë e Kuvendit të vendos për këtë propozim.

Lulzim Rafuna sqaroi se me këtë propozim-vendim kërkohet të vazhdohet periudha kalimtare e disa produkteve bujqësore, lirimi i furnizimit të mallrave për donatorët dhe organizatat ndërkombëtare dhe për disa grupe të caktuar që deri më tani kanë qenë të liruara nga TVSH-ja dhe nuk ka pasur efekt buxhetor pasi që buxheti nuk është bazuar në këto të hyra të mundshme.

Sali Asllanaj vlerësoi se është një propozim që është në interes të përkrahjes dhe mbështetjes së sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit të këtij sektori dhe si të tillë e përkrah zgjatjen e periudhës për lirimet nga TVSH-ja.

Hasime Krasniqi vlerësoi se është një propozim-vendim për tu përshëndetur. Edhe pse kemi një humbje potenciale të të hyrave buxhetore, efekti pozitiv i tij është në zhvillimin e sektorit të bujqësisë, zëvendësimin e produkteve të importuara me ato vendore dhe me efekt pozitiv në përmirësimin e bilancit tregtar dhe në përgjithësi do të ndikojë në uljen e papunësisë. Të gjitha këto rezultate do të vërehen në të ardhmen.

Naser Osmani theksoi se e ka lexuar me vëmendje këtë propozim-vendim dhe vlerëson pozitive propozimin e lirimeve nga TVSH-ja, por se sqarimet e dhëna nuk janë të qarta. Parashihet të bëhet lirimi për disa grupe të veçanta apo lirimet për TVSH-në e zbritshmi, janë disa qështje që nuk janë të sqaruara mirë. I keni përfshirë lirimet për teknikët dentar që përfitojnë më së shumti, ndërkohë që nuk janë përfshirë lirimet për disa produkte tjera të rëndësishme medicinale. Mendoj është e domosdoshme të jepen sqarime shtesë, pasi që është vështirë të arsyetohet në seancë plenare.

Kryetarja sqaroi se propozim-vendimi është proceduar në Kuvend në pajtim me nenin 64.2 të Ligjit për TVSH-në, ku parashihet mundësia e vazhdimit të periudhën kalimtare të lirimeve nga TVSH-ja.

Latif Gashi theksoi se ndoshta ligji për TVSH-në përmend produkte që kërkohet ‘iu vazhdohet periudha e lirimeve nga TVSH-ja, por se janë disa qështje siç është rasti i OJQ-ve që nuk përputhet me ato çfarë kemi paraparë në Ligjin për Bankat dhe Institucionet Mikrofinanciare, ku kemi paraparë që institucionet mikrofinanciare duhet të paguajnë tatim për kapitalin dhe veprimtarinë e tyre. Askush nuk mund t’a kontestoj atë nuk ka deputet që thotë kjo është e dëmshme. Kjo është shumë e mirë për vendin, për qytetarin sidomos ndikon në ekonominë e vogël familjare, në bizneset e vogla e tjera. Angazhohen shumë njerëz në punë dhe sado që duket që ne po humbim si buxhet, në anën tjetër po vjelim shumë donacione që ndoshta i afrohet shifrës 1 miliard. Askush nuk jemi kundër por është mirë të ulemi dhe t’i shikojmë dhe t’japim një kuptim pak më të mirë dhe ,mos të krijojmë paqartësi dhe të hapet debat në seancë.

Lulzim Rafuna sqaroi se kur kemi hartuar ligjin jemi bazuar në direktivën e BE-së. Ideja është që stafi i cili shërben në institucionet religjioze dhe për OJQ-ët konsiderohet si staf vullnetar jo që paguhet, dhe këtu është ideja që ai për atë shërbim që ofron të lirohet prej TVSH-së. E marr për obligim që të përgatis një arsyeshmëri për këtë.

Kryetarja mendoj që ne nga diskutimet që dolën është disponimi për të miratuar këtë propozim-vendim, mirëpo u ngritën disa qështje dhe kemi nevojë për disa sqarime më të detalizuara dhe për një arsyeshmëri pak më të mirë.

Naser Osmani e jona është të deklaroj a përkrah apo jo propozim-vendimin e Qeverisë. Nëse e përkrah në tërësi atëherë drejtori duhet të na sjell pak më të sqaruar sepse është shumë e ngarkuar.

Lulzim Rafuna njoftoi se për ATK-në është e nevojshme me i njoftuar të gjithë tatimpaguesit së paku një muaj më herët për zgjatjen e periudhës kalimtare. Sa i përket sqarimeve unë do t’i sjelli, mirëpo kjo është çështja se nuk mund t’a ndajmë pasi që përcaktohet kështu me nenin 64.2.

Latif Gashi unë besoj se nuk është mirë t’i ndajmë pasi që në kuadër të një nenin janë edhe sfera tjera për sport, arsim apo edhe të religjionit dhe është mirë të dihen dhe të legalizohen këto se sa të na vijjnë në të zezën dhe t’i edukoj dikush nëpër podrumë, kështu që më mirë është që të dihen zyrtarisht veprimtaritë e tyre.

Kryetarja po e hedhim në votim propozim-vendimin siç na ka ardhur nga qeveria me kusht që brenda dy ditëve të na sjellin edhe sqarimet tjera që cilat i’a bashkangjesim këtij material si sqarime plotësuese.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/94 të datës 10 tetor 2012, për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar, nga 1 janari 2013 deri më 31 dhjetor 2014 në pajtim me nenin 64.2 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Projektligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësinë, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetarja theksoi se kemi nevojë për sqarime më të detalizuara në lidhje me koston buxhetore të këtij projektligji. Ne kemi informata që kostoja e implementimit të këtij ligji është përfshirë në buxhet dhe në KASH, mirëpo është mirë që t'a diskutojmë me ju, dhe nuk është në inters të askujt të miratohet një ligj me kosto buxhetore sepse ai ligj nuk do të implementohet në praktikë. Sa i përket amendamenteve të komisionit funksional, kemi identifikuar vetëm një amendamentet që mund të prodhojë implikime buxhetore shtesë, është amendamenti 51 që ka të bëjë me caktimin e numrit prej 7 të anëtarëve të bordit drejtues të SHSKUK-së emëruar nga Ministria e Shëndetësisë. Në projektligj përmendet bordi por jo edhe numri, prandaj një sqarim për këtë do të ishte i nevojshëm.

Ferid Agani theksoi se me këtë projektligj do të mundësohet fillimi i fazës së parë të reformave të sistemit shëndetësor, fazë kjo e cila do të pasohet me miratimin e projektligjit të sigurimeve shëndetësore si fazë e dytë. Këto dy faza janë definuar me koordinim të ngushtë me Ministrinë e Financave, FMN dhe Bankën Botërore. Kostoja buxhetore e këtij ligji është paraparë tërësisht në buxhetin e vitit 2013 dhe në KASH. Proces i amendamentimit të projektligjit ka shkuar në konsultime të ngushta të Ministrisë së Shëndetësisë dhe komisionit funksional. Te bordi drejtues qartësimi është se bëhet fjalë për 7 anëtar të bordit drejtues, në këtë aspekt nuk ka asnjë diskrepancë të veçantë. Ministri sqaroi edhe përmbajtjen e projektligjit dhe qëllimet që synohen të arrihen me këtë ligj në kontekst të reformës në shëndetësi.

Sali Asllanaj përgëzoi Ministrin për këtë iniciativë që ka marr rreth ndryshimit të ligjit për shëndetësi. I dëshiroj sukses dhe dëshiroj dhe kam bindjen e plotë që e ka studiuar dhe e ka analizuar disa shtete që e kanë kaluar këtë fazë si ne dhe në këtë mënyrë e ka pas rrugën e trasuar nga një përvojë e ngjashme. Në këtë kontekst pyes Ministrin sa është i bindur që do ta zbatojnë këtë ligj? Do të jem shumë përkrahës i fuqishëm i reformës që keni filluar, do të kem dorën ngritur gjithmonë për mjete materiale aq sa kemi mundësi të ndihmojmë që ta kthejmë shëndetësinë në këmbë të qëndrueshme.

Latif Gashi ne morë sqarimet për dilemën që kishim për shtatë anëtarët e bordit, mirëpo mund të kemi problem të kalohet në seancë, pasi që në deklaratën financiare, thuhet se kostoja nuk është përfshirë në KASH, as për vitin e parë, të dytë e as të tretë, do të ishte mirë ta kemi më konkretisht se nga mendohet të sigurohen këto mjete. A ka planifikuar prej buxhetit të vet Ministria apo si?

Naser Osmani theksoi se ne jemi të vetëdijshëm për reformën e thellë që po bëhet në shëndetësi, një e mirë e kësaj Ministrie ka qenë se gjithmonë kanë qenë njerëz profesionist në këtë institucion. Ne e kemi diskutuar këtë qështje qysh nga fillimi i Kuvendit të parë, çështjen e krijimit të fondeve sidomos fondi shëndetësor. Problemi ka qenë gjithmonë ligji me menaxhimin e financave publike që nuk ka lejuar krijimin e fondeve për arsye se ka qenë një buxhet i konsoliduar. Çështja që ngritet ka të bëjë me kompetencën e menaxhimit të financave, a do të jetë kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë, nëse juve ju bartet kjo kompetencë cili do të jetë ky raport me ligjin që ne e quajmë ligjin themelor, ligjin kushtetues për menaxhim të financave. Është pak e rëndësishme numri i anëtarëve të bordit aq më tepër nuk janë problem paratë, pasi që janë shumë humbje të parasë jashtë Kosovës për qështje shëndetësore. Nuk ka diskutim që ligji duhet të përkrahet, por pyetja është çka mundet parlamenti, çka mundet komisioni të punoj në të ardhmen kur të vjen koha e zbatueshmërisë së këtij ligji të jemi në rregull me ligjet tjera.

Ferid Agani theksoi se kostoja e ligjit është mbuluar nga Ministria e Financave dhe është përfshirë në buxhetin 2013 dhe KASH. Çdo aspekt i legjislacionit i cili ka të bëjë me ligjin e shëndetësisë është analizuar nga detalisht nga dhe kanë pranuar që në Kosovë të themelohet fondi i sigurimeve shëndetësore dhe kjo deklaratë e tyre mund të shihet në letër e qëllimeve që e ka miratuar bordi ekzekutiv i FMN në prill të këtij viti, ku shkruan qartë se në Kosovë do të themelohet sistemi i

sigurimeve publike shëndetësore në fazën e dytë të reformës pas zbatimit të suksesshëm të ligjit të shëndetësisë dhe i kanë vë disa parakushte, dhe ato parakushte janë: çmimorja e shërbimeve, pakoja themelore e kujdesit shëndetësor, sistemi funksional i formimit shëndetësor, kontraktimi i shërbimeve. Kur është në pyetje përgjegjësia financiare, kompetenca e menaxhimit të financave është qartësuar. Për mjetet të cilat do të jenë në dispozicion të institucioneve shëndetësore nga buxheti i Kosovës ato do të kontraktohen me agjensionin e financimit të shëndetësisë që është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe i nënshtrohen në tërësi ligjet për menaxhimin e financave publike. Pjesën e të hyrave të cilat do t'i realizojnë në kontraktimin me kompanitë private të sigurimeve shëndetësore në vend ose jashtë vendit ngelin në vet institucionin shëndetësor, shfrytëzohen në bazë të parimeve të një institucioni jo profit, pra riqarkullohen për stimulimin e cilësisë më të mirë të shërbimeve shëndetësore dhe pagesës së punëtorëve shëndetësor dhe punësimit të punëtorëve të rinj në sistemin shëndetësor dhe i nënshtrohen ligjeve financiare të cilat vlejnë edhe për ndërmarrjet e tjera publike të cilat janë nën pronësinë e Qeverisë së Kosovës.

Kryetarja marrëveshjet pa u nënshkruar nuk mund t'u besojmë shumë, por Ministër megjithatë unë e kam një qështje për sqarim, te neni 60 ka ndryshuar titulli Shërbimi Spitalor dhe Klinik-Universitar i Kosovës, ndërkaq te neni 52 thuhet se pas nenit 60, shtohen 5 nene të reja, a janë të parapara në buxhet dhe për çfarë është fjala, pse janë shtuar në këtë formë, dhe ku është dallimi nga ajo çka është propozuar me ligjin bazë?

Ferid Agani sqaroi se është fjala vetëm për elaborimin më të detajuar për funksionimit të bordit drejtues të shërbimit spitalor klinik-universitar pra për kompetencat, për mënyrën e udhëheqjes, për mënyrën e menaxhimit financiar, nuk ka implikime buxhetore në ato amendamente.

Kryetarja SSHK themelohet me këtë ligj. A është fjala për ndonjë të re?

Ferid Agani Shërbimi Spitalor Klinik-Universitar i Kosovës nënkupton Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me 7 spitalet rajonale. Pra nuk ka implikime buxhetore sepse këto janë institucione ekzistuese por do të ketë riorganizim të këtyre institucioneve dhe forma të reja të menaxhimit.

Xhevdet Neziraj prej Ministrisë morëm sqarime dhe qëllimi i Komisionit të Buxhetit është që të përkrahim Ministrinë e Shëndetësisë në ato mundësitë buxhetore për arsye që këto shërbime i marrin të gjithë qytetarët të të gjitha partive dhe të të gjitha etniteteve. Unë besoj që është një prej ligjeve me rëndësi, ku do të presim shërbime më të mira dhe na gëzon fakti që është harmonizuar edhe me Ministrinë e Financave dhe FMN dhe ne presim që këto të realizohen.

Sevdije Lama theksoi se tek amendamenti 38 neni 41 është shtuar një paragraf: Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë që të mundësojnë profesionistëve shëndetësor të punësuar në to që të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore brenda vet institucionit publik shëndetësor edhe kjo do të rregullohet me një akt nënligjor të veçantë. A mendoni që kjo do të funksionoj? Si do t'a rregulloni?

Ferid Agani theksoi se çmimorja është gati dhe së shpejti do të publikohet, ajo është punuar në bashkëpunim me ish Ministrin e Shëndetësisë të Sllovenisë dhe ish drejtorin e sigurimeve shëndetësore të Maqedonisë. Akti nënligjor është i elaboruar, ekziston në Ministri të Shëndetësisë, dhe në momentin që miratohet ligji do të hyj në fuqi shumë shpejt, dhe me këtë ne do të provojmë që të plotësojmë edhe kërkesat e punëtorëve shëndetësor. Kjo është një përvojë evropiane dhe e kemi përvetësuar një gjë të tillë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për Shëndetësi dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për regjistrimin e bujqësisë dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Të ndryshme

Kryetarja meqenëse Projektligji për sistemin e pagesave është miratuar në parim në Kuvend, për të cilën jemi komisioni funksional, është e nevojshme të krijojmë grupin punues që do të punojë në shqyrtimin e këtij projektligji.

Sipas propozimeve, komisioni caktoi grupi punues për shqyrtimin e projektligjit për sistemin e pagesave, në përbërje: Naser Osmani (kryesues), Jelena Bontic, Latif Gashi, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj.

Kryetarja propozojë që në fazën e shqyrtimit të projektligjit të buxhetit 2013, të angazhojë dy ekspertët që ishin angazhuar vitin e kaluar të na ndihmojnë edhe këtë vit në analizat për kërkesat buxhetore dhe raportet nëntëmujore të agjencive të pavarura.

Komisioni vendosi që të angazhojë dy ekspert, Teki Shala dhe Safet Fazliu për analizimin e Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Kryetarja njoftoi anëtarët se të gjitha institucioneve të pavarura u'a kemi dërguar një shkresë që t'i sjellin raportet nëntë mujore për rrjedhën e shpenzimeve të tyre dhe të gjitha institucioneve që kanë bërë kërkesa u'a kemi dërguar formularët, të cilët janë publikuar edhe në web faqen e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona